

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni dhe 17207646 CANADA INC ALFI, me seli të regjistruar në Suite MZ400, 1000 de La Gauchetiere, Montreal, QC H3B 0A2, Kanada, të dorëzuar përmes Ljupka Noveska Andonova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 29.10.2025, miratoi këtë:

AKTVNEDIM

1. Vërtetohet përqendrimi me të cilin ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, dhe 17207646 CANADA INC, me seli të regjistruar në Suite MZ400, 1000 de La Gauchetiere, Montreal, QC H3B 0A2, Kanada, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ALFI M1, shoqëri e posaçme për investime, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, MERKUR tregti, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Cesta na Okroglo 7, 4202 Naklo, Republika e Sllovenisë, dhe MERKUR energji, zgjidhje energjetike, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Cesta na Okroglo 7, 4202 Naklo, Republika e Sllovenisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin e dukshëm, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftim për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për vendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për iniciimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 03.10.2025, e plotësuar më 10.10.2025, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, dhe 17207646 CANADA INC, me seli të regjistruar në Suite MZ400, 1000 de La Gauchetiere, Montreal, QC H3B 0A2, Kanada, me të cilin ALFI, menaxhim i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k. dhe 17207646 CANADA INC do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ALFI M1, shoqëri e posaçme për investime, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë,

Slloveni, dhe MERKUR tregti, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Cesta na Okroglo 7, 4202 Naklo, Republika e Sllovenisë, dhe MERKUR energji, zgjidhje energjetike, sh.p.k., me seli të regjistruar në adresën Cesta na Okroglo 7, 4202 Naklo, Republika e Sllovenisë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimin të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimeve dhe shtojcave të tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ALFI menaxhon fonde alternative të investimeve me fondet investuese: ALFI II, SIS, ALFI DIJ CEE, AIS, të themeluara me emrin ALFI DIJ CEE, fonde alternative të investimeve, dhe ALFI SIS, të themeluara me emrin ALFI, fonde të veçanta investimi.

Grupi ALFI është aktiv kryesisht në menaxhimin e investimeve dhe aseteve, veçanërisht në fushat e shitjes me pakicë, arkëtimit të borxheve dhe investimeve të tjera alternative. Grupi ALFI kryen analiza të investimeve dhe menaxhon fondet investuese, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve pjesërisht u është besuar shoqërive të tjera brenda grupit.

Në strukturën e tij më të gjerë, Grupi ALFI ka të regjistruar shoqërinë e mëposhtme të varur në Maqedoninë e Veriut:

- APOLLO MK SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në adresën Bulevardi Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Babë, Shkup, aktive në tregtinë me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, galanterisë për fëmijë dhe tekstilit për fëmijë.

17207646 CANADA INC është një shoqëri kanadeze e themeluar më 1 gusht 2025, me veprimtari afariste të regjistruar “veprimtari të shoqërive holding”.

As 17207646 CANADA INC dhe as ndonjë nga subjektet e tij të lidhura aktualisht nuk janë të pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, as nuk realizojnë qarkullim apo kryejnë çfarëdo veprimtarie afariste në Maqedoninë e Veriut.

ALFI M1, shoqëri e posaçme për investime, sh.p.k., është një shoqëri holding, veprimtaria kryesore e së cilës është pronësia e pjesëmarrjes në MERKUR tregti.

MERKUR tregti sh.p.k. merret kryesisht me shitje me pakicë përmes dyqaneve të specializuara, përkatësisht me shitjen me pakicë të produkteve “bëje vetë” (DIY) për amvisëri dhe përdorues joprofesionalë, siç janë vidat, bojërat, veshjet mbrojtëse, si dhe me shitjen e pajisjeve shtëpiake, të cilat i shet në qendrat MERKUR në të gjithë Slloveninë.

MERKUR energji, zgjidhje energjetike, sh.p.k., merret kryesisht me produkte dhe shërbime që lidhen me panele solare, pompa termike, bateri, sisteme për ruajtjen e baterive, sisteme ventilimi, karikues për automjete elektrike – të cilat u ofrohen si personave fizikë ashtu edhe klientëve komercialë, me fokus në ndihmën ndaj klientëve për qëllim të uljes së kostove të energjisë, arritjes së pavarësisë energjetike dhe mbështetjes së qëndrueshmërisë ekologjike përmes teknologjive të rinovueshme dhe sistemeve efikase.

Grupi i synuar (ndërmarrjet mbi të cilat fitohet kontrolli) nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut; megjithatë, ka realizuar një qarkullim të vogël në vitin 2024 përmes shitjeve me shumicë ndaj franshizës në Maqedoninë e Veriut, e cila menaxhohet

nga një shoqëri që nuk është e lidhur me Grupin e Synuar – MERKUR MAQEDONIA SH.P.K. Shkup, nga të cilat shumica janë shitje të produkteve kopshtarie dhe teknike.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ